



SHKOLLA E MESME E MJEKËSISË
"KEKA – MED"
KLINË



Adresa: Rr."Sadik Rama", p.n. – Klinë, 32.000 / Email: shmpkekamed@gmail.com / Kontakt: +383(0) 44/48 663001

Nr. prot: 01-1499/26

Më: 07/07/2026

Vendimi AKK-së: 01/465

MASH nr. Vendimit, 03-1893/26

Në bazë të nenit 28, paragrafi 2 të Ligjit nr. 04/L-138 për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe në bazë të nenit 12, paragrafi 1 të Ligjit nr.04/L-143 për Arsim dhe Aftësim për të rritur në Republikën e Kosovës, Shkolla e Mesme e Mjekësisë "KEKA-MED" në Klinë, shpall:

KONKURS

PËR REGJISTRIM NË ARSIMIN PËR TË RRITUR

Shkolla e Mesme e Mjekësisë (IAAP) "KEKA-MED" në Klinë, shpall konkursin për regjistrimin e vijuesve të rritur në arsimin e mesëm të lartë të arsimit profesional për afatin e Janarit.

Kandidatet e interesuar të cilët i plotësojnë kushtet e parapara me këtë konkurs, mund të regjistrohen në klasën e X-të, XI të, dhe XII-të, në drejtimin dhe profilet si në tabelë:

Planifikimi						
Viti shkollor 2026-2027						
Nr	Shkolla	Drejtimi	Profili	Paralele	Nxënës	Gjithsej
1.	SHMM "KEKA-MED"	Mjekësi	Bashkëpunëtor Profesional i Infermierisë	1	16	16
2.	SHMM "KEKA-MED"		Teknik i Farmacisë	1	8	8
3.	SHMM "KEKA-MED"		Asistent Dentar	1	10	10
	SHMM "KEKA-MED"		Teknik i Laboratorit Mjekësor	1	8	8
	SHMM "KEKA-MED"	TIK	IT me Elektronikë	1	8	8
Totali:				5	50	50

Regjistrimi i vijuesve në programin "Arsim për të rritur", bëhet sipas procedurave të njëjta të regjistrimit për nxënësit e rregullt, siç është paraparë në Ligjin nr. 04/L-143 për Arsim dhe Aftësim Profesional për të rritur në Republikën e Kosovës dhe Udhëzimeve Administrative të MASHTI-it.

Në programin "Arsimi për të rritur" në shkollat e mesme të larta, vijuesve ju mundësohet që një vit të plotë shkollor ta përfundojnë në afat prej 18 jave mësim (UA nr. 40/2006 MASHT).

Të drejtë regjistrimi kanë të gjithë të interesuarit, të cilët kanë kaluar moshën për të qenë nxënës të rregullt (mbi moshën 17 vjeçare).

Dokumentet e nevojshme:

1. Dëftesat e klasave të kryera paraprake;
2. Certifikata e lindjes;
3. Pagesa.

Shkollimi për vijuesit e arsimit të mesëm të lart është me pagesë. Pagesat bëhen në objektin e Shkollës së Mesme të Mjekësisë “KEKA-MED” në Klinë.

Vijuesit të cilët ndërrojnë profilin, do t’u nënshtrohen provimeve diferenciale, bazuar në UA 16/2011, dt: 30/12/2011 të MASHT-it. Kandidatet të cilët ndërrojnë drejtimin, jenë të obliguar që paraprakisht t’u nënshtrohen provimeve diferenciale. Dhënia e provimeve plotësuese dhe diferenciale bëhet në afat të veçantë nga vijimi i klasës, për të cilën kandidati është paraqitur për regjistrim.

Dëftesat dhe diplomat që merren në programin “Arsimi dhe aftësimi për të rritur” janë të barasvlershme me diplomat e arsimit formal.

Afati i paraqitjes së dokumenteve

Konkursi është i hapur 30 ditë nga data 07.07.2026, pra nga dita e publikimit në mjetet e informimit publik. Paraqitja e dokumenteve bëhet çdo ditë pune nga ora 8:00 -16:00, në objektin e Shkollës së Mesme të Mjekësisë “KEKA-MED” në Klinë.



Drejtori i shkollës:

Msc. Ilir Keka